

GJITHËPËRFSHIRJA NË ARSIMIN PARASHKOLLOR

Gjithëpërfshirja në arsimin parashkollor është një proces që bën të mundur, që të gjithë fëmijët të nxënë dhe të marrin pjesë në mënyrë efektive në procesin e të nxënies, duke përfshirë edhe grupet e fëmijëve në nevojë. Për këtë arsye sistemi arsimor dhe gjithë institucionet parashkollore duhet të ndryshojnë për t'ju përshtatur larmisë së nevojave të fëmijëve.

Vlerësimin në mënyrë të barabartë të të gjithë fëmijëve, mësuesëve, prindërve, etj.

Mbështetjen e diferencave të fëmijëve drejt lojës dhe të nxënies ta shohë më tepër si përkrahje/ndihmë, sesa si probleme që duhen zgjidhur.

Të drejtën e fëmijëve për një edukim cilësor.

Pakësim të pengesave për të luajtur, për të nxënë dhe për të marrë pjesë në veprimtari të ndryshme për të gjithë fëmijët, e jo vetëm për ata që kanë nevojë arsimore të veçanta.

Rritjen e pjesëmarrjes aktive të fëmijëve në lojë/veprimtari/të nxënë për eliminimin e pengesave, në dobi të fëmijëve.

Ristrukturim të kulturave, politikave dhe praktikave brenda institucionit për t'iu përgjigjur larmisë së nevojave të fëmijëve në komunitet.

Vënien e theksit mbi rolin e ndërsjelltë të institucioneve parashkollore dhe komunitetit në zhvillimin e vlerave dhe progresin të fëmijëve

Forcimin e marrëdhënieve të mbështetjes së ndërsjelltë mes institucioneve parashkollore/mes tyre dhe komunitetit.

Njohjen e faktit që gjithëpërfshirja në edukimin parashkollor është një aspekt i gjithëpërfshirjes në shoqëri.

Udhëzuesi për gjithëpërfshirje në institucionet parashkollore është një komplet materialesh për të mbështetur gjithëpërfshirjen në të gjitha veprimtari të mësimore-edukative, përfshirë këtu edhe infrastrukturën. Udhëzuesi stimulon zhvillimin e lojës, të nxënies dhe pjesëmarrjen e fëmijëve në aktivitete duke treguar mënyrën për një përdorim më të mirë të burimeve të dobishme, minimizimin e pengesave dhe krijimin e një kulture bashkëpunimi. Ai, nxit të gjithë mësueset, prindërit dhe fëmijët që të japin ndihmesën e tyre për një plan zhvillimi gjithëpërfshirës dhe për ta vënë atë në praktikë.

Gjithëpërfshirja në arsimin parashkollor synon:

Si të punojmë me udhëzuesin për gjithëpërfshirjen

Udhëzuesi për gjithëpërfshirjen është përshtatur nga versioni i hartuar për shkollat. Hartimi i udhëzuesit i jep përgjigje disa prej shqetësimeve që kanë sot institucionet tona shkollore dhe parashkollore. Udhëzuesi për gjithëpërfshirjen është përshtatur për arsimin parashkollor nga Tony Booth & Denise Kingstone. Redaktimi dhe nxjerrja në botim nga CSIE (Qendra për studime mbi edukimin dhe arsimin gjithëpërfshirës) Bristol, UK.

Përdorimi i materialeve të udhëzuesit mundëson përmirësimin e punës në institucionet parashkollore, duke marrë në konsideratë tri dimensione të cilat marrin rëndësi të vecantë për strukturimin e zhvillimit të gjithëpërfshirjes në to. Këto dimensione janë: kulturat, politikat dhe praktikat.

Kulturat pasqyrojnë qëndrimet, vlerat dhe besimet e thella. Përshtatja ndaj kulturave është themelore për mbështetjen e zhvillimit. Politikat kanë lidhje me mënyrën e drejtimit të kopshtit dhe me ndryshimin e planifikimit kurse praktikat kanë të bëjnë me atë që ndodh në veprimtaritë me fëmijët, zhvillimet dhe përdorimet e burimeve. Çdo dimension është i ndarë në dy seksione dhe së bashku formojnë një kuadër planifikimi, i cili përcakton zonat që mund të kërkojnë vëmendje, nëse mjedisi duhet të zhvillohet si një i tërë.

3 dimensionet e udhëzuesit



Kuadri i planifikimit

DIMENSIONI A Krijimi i kulturave gjithëpërfshirëse
Ndërtimi i komunitetit

Krijimi i vlerave gjithëpërfshirëse

DIMENSIONI B Hartimi i politikave gjithëpërfshirëse
Krijimi i një mjedisi/institucioni për të gjithë

Organizimi i përkrahjes për diversitetin (të qenit ndryshe)

DIMENSIONI C Zhvillimi i praktikave gjithëpërfshirëse
Organizimi i lojës dhe të nxënësve

Mobilizimi i burimeve

Një komplet prej 46 treguesish tregojnë synimet dhe drejtimit për ndryshime drejt gjithëpërfshirjes. Zakonisht treguesit vendosen sipas kontekstit dhe vecorive në institucionin ku zbatohen. Jo gjithmonë ata, mund të jenë të njëjtë për çdo institucion. Çdo tregues është i lidhur me dhjetë deri në njëzet pyetje, të cilat ofrojnë ide shtesë për aktivitetet zhvillimore dhe shërbejnë edhe si kritere për vlerësimin e përparimit.

Dimensionet dhe seksionet

Strukturojnë mënyrën me të cilën ju mendoni për planin tuaj për të ndryshuar mjediset.



Treguesit

Ju ndihmojnë të përqendrohni në ndryshimet/çështjet që kanë nevojë të merren parasysh.



Pyetjet

Mbështesin një rishikim të detajeve të imëta të mjedisit në mënyrë të tillë që të merremi me çështjet sfiduese.



Dimensionet, seksionet dhe treguesit në udhëzues

DIMENSIONI A

Krijimi i kulturave gjithëpërfshirëse

- A1. Ndërtimi i komunitetit**
- A1.1 Të gjithë fëmijët janë të mirëpritur
 - A1.2 Fëmijët ndihmojnë njëri-tjetrin
 - A1.3 Mësueset e kopshtit bashkëpunojnë me njëra tjetrën.
 - A1.4 Mësueset dhe fëmijët e trajtojnë njëri-tjetrin me respekt.
 - A1.5 Ka partneritet midis mësueseve dhe prindërve
 - A1.6 Mësueset krijojnë lidhje mes aktiviteve të kopshtit me jetën e fëmijëve në shtëpi.
 - A1.7 Drejtueset dhe mësueset bashkëpunojnë mes tyre.
 - A1.8 Komuniteti është i përfshirë në edukimin e fëmijëve.

A2. Krijimi i vlerave gjithëpërfshirëse

- A2.1 Drejtueset, mësueset dhe prindërit e kuptojnë gjithëpërfshirjen në edukim.
- A2.2 Nga të gjithë fëmijët pritet të arrijnë më shumë.
- A2.3 Fëmijët vlerësohen në mënyrë të njëjtë.
- A2.4 Institucioni parashkollor i ndihmon fëmijët të ndihen mirë me vetveten.
- A2.5 Kopshtë përpiqet të minimizojë çdo formë diskriminimi

DIMENSIONI B

Hartimi i politikave gjithëpërfshirëse

- B1 Krijimi i një institucioni parashkollor për të gjithë**
- B1.1 Emërimi i personelit mësimorë bëhet në mënyrë të drejtë.
 - B1.2 Të gjithë punonjësit të rinj u ofrohet ndihma për t`u sistemuar në institucione parashkollore.
 - B1.3 Institucioni parashkollor përpiqet të pranojë të gjithë fëmijët e komunitetit.
 - B1.4 Institucioni parashkollor mundëson qasje fizike për të gjithë njerëzit.
 - B1.5 Fëmijëve u ofrohet ndihma për t`u përshtatur me mjedisin e kopshtit.
 - B1.6 Mësueset i përgatisin fëmijët për lëvizje në mjedise të tjera (kopshte/shkolla,etj.).

B2. Organizimi i përkrahjes për diversitetin

- B2.1 Të gjitha format e mbështetjes janë të koordinuara.
- B2.2 Aktivitetet trajnuese të mësuesve, i ndihmojnë ata, t'u përgjigjen larmisë së nevojave fëmijëve.
- B2.3 Politikat e punës për "nevojat e veçanta për edukim" janë politika gjithëpërfshirëse në institucionet parashkollore.
- B2.4 Praktikat e punës me fëmijët me nevoja të veçanta përdoren për të zvogëluar pengesat e tyre në lojë, në të nxënë dhe në pjesëmarrje.
- B2.5 Presioni për të veçuar fëmijët e cilësuar si "të vështirë" është ulur.
- B2.5 Pengesat për të mos frekuentuar institucionin janë zvogëluar
- B2.6 Keqtrajtimet/ndëshkimet/ngacmimet janë minimizuar.

DIMENSIONI C

Zhvillimi i praktikave gjithëpërfshirëse

- C1. Organizimi i lojës dhe të nxënësve**
- C.1.1 Programet planifikohen duke marrë parasysh nevojat e cdo fëmije.
 - C.1.2 Veprimtaritë nxisin komunikimin e të gjithë fëmijëve.
 - C.1.3 Veprimtaritë mësimore -edukative ndikojnë në pjesëmarrjen aktive të të gjithë fëmijëve.
 - C.1.4 Veprimtaritë pjesëmarrëse nxisin pjesëmarrjen aktive të gjithë fëmijëve
 - C.1.5 Veprimtaritë i ndihmojnë fëmijët të kuptojnë diferencat ndërmjet njerëzve.
 - C.1.6 Fëmijët përfshihen në mënyrë aktive në lojë dhe në të nxënë.
 - C.1.7 Fëmijët bashkëpunojnë në lojë dhe në të nxënë.
 - C.1.8 Vlerësimet nxisin arritjet e fëmijëve.
 - C.1.9 Drejtueset, mësueset dhe prindërit bashkëpunojnë në planifikimet orientuese vjetore/ mujore/ ditore.
 - C. 1.10 Të gjithë fëmijët marrin pjesë në aktivitete të tjera të kopshtit.

C2. Mobilizimi i burimeve

- C.2.1 Mjedisi fizik i kopshtit është organizuar në mënyrë të tillë që të nxisë lojën, të nxënë dhe pjesëmarrjen aktive të fëmijëve.
- C.2.2 Njohuritë profesionale të mësueseve shfrytëzohen maksimalisht.
- C.2.3 Ndryshimet mes fëmijëve përdoren si burime për të mbështetur lojën, të nxënë dhe pjesëmarrjen.
- C.2.4 Burimet e kopshtit shpërndahen në mënyrë të drejtë me qëllim përkrahjen e gjithëpërfshirjes në edukim.

Modeli i një treguesi me pyetjet e tij

DIMENSIONI A **Krijimi i kulturave gjithëpërfshirëse**

A.2 | **Krijimi i vlerave gjithëpërfshirëse**

Treguesi A.2.4 | ***Institucioni parashkollor i ndihmon fëmijët të ndihen mirë***

- a) A janë të gjithë fëmijët të sigurt për një ndërveprim të rregullt e të vazhdueshëm me mësueset, në mënyrë individuale apo në grupe?
- b) A mendojnë të gjithë fëmijët se mësueset i duan ata?
- c) A konsiderohet loja e rëndësishme për rolin e saj, sesa një mjet për të realizuar qëllime të veçanta në të nxënë?
- d) A njihet vetëvlerësimi si diçka jetike për mirëqenien e një fëmije dhe a zbatohet ai në të gjitha aktivitetet dhe marrëdhëniet që ka fëmija me individë të tjerë?
- e) A e njohin/pranojnë mësueset rëndësinë e respektit për identitetin dhe kulturën e fëmijës?
- f) A mund të mbështeten fëmijët kur ata janë të mërzitur, të dëshpëruar apo të inatosur gjatë një dite të caktuar?
- g) A i përgjigjen mësueset dhe punonjëset e kopshtit në mënyrë dashamirëse lodhjes dhe "streseve" të fëmijëve?
- h) A mirëkuptohen nga mësueset dhe punonjëset e tjera të kopshtit fëmijët kur duan të ushqehen, kur janë të lodhur, të lumtur, të trishtuar apo të vetmuar?
- i) A janë mësueset të ndjeshme ndaj mënyrave të ndryshme me të cilat fëmijët duan të mbështeten kur janë të shqetësuar, p.sh të luajnë me ta ndërkohë kur fëmija pret prindin, të kenë praninë e një të rrituri kur atyre u nevojitet, etj?
- j) A u takon të gjithë fëmijëve një hapësirë dhe kohë individuale?
- k) A e njohin mësueset vlefshmërinë e këngës dhe muzikës si mënyra që ndikojnë në përmirësimin e gjendjes shpirtërore të fëmijëve?
- l) A i jepet rëndësi lodrave/objekteve dhe pajisjeve të tjera në klasat e fëmijëve?
- m) A kanë mundësi mësueset dhe personeli i kopshtit t`u japin fëmijëve ndihmë shëndetësore (ilace, mjekime, flor dhembësh) kur ata kanë nevojë?
- n) A janë ushqimet pjesë e një diete të shëndetshme për fëmijët e kopshtit?
- o) A e shmang kopshti vlerësimin e vazhdueshëm të ecursisë së fëmijëve?
- p) A angazhohen fëmijët në veprimtari jashtë në natyrë po ashtu si brenda?
- q) A u jep kopshti fëmijëve udhëzime për të kuptuar se kujt mund t`i besojnë dhe si mund ta mbrojnë vetëveten?